



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E PROJEKTEVE/ INTEGRIMIT EVROPIAN/ PERFORMANCËS DHE
DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE

Lënda: Raportim për ecurinë e zbatimit të projekteve në periudhën Janar-Tetor 2025

Për: Këshillin Bashkiak Përmet

Drejtorja e Projekteve në kuadër të përmbushjes së funksioneve të saj dhe në kuadër të transparencës dhe informimit institucional, paraqet raportin për ecurinë e zbatimit të projekteve për periudhën Janar-Tetor 2025. Ky Raport përfshin projektete në zbatim, projektet e përfunduara gjatë kësaj periudhe dhe rezultatet e arritura, vonesat, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit dhe angazhimet për periudhën në vazhdim.

Projektet përfshijnë projekte të financuara nga Buxheti i bashkisë, Fondet qendrore, Fonde të donatorëve të huaj.

✓ **PROJEKTE TË PËRFUNDUARA:**

1. Projekti Key People, Key Knowledge i financuar nga Bashkimi Evropian nisi zbatimin

në vitin 2023 dhe kishte si qëllim krijimin e mundësive të reja pune/biznesi për gratë dhe të rinjtë e papunë duke dhënë një alternativë të qëndrueshme ndaj riskut të përfshirjes në kultivimin e kanabisit. Ky projekt pati ndikim tepër pozitiv në komunitet pasi pati grupe të ndryshme interesi që përfituan nga aktivitetet e zbatuara. Mund të përmendim rikonstrukcionin e sallës së PingPong; ndërtimi i një qendre informacionit turistik në Nj.Adm Petran; rritja e kapaciteteve për startup dhe mbështetje me grante; inkubator biznesi; bibliotekë lëvizëse për aksesin e zonave rurale në bibliotekë etj. Projekti ka përfunduar zbatimin në 09 Tetor 2025.

2. Projekti UNDP -së “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur” i financuar nga UNDP nisi zbatimin në muajin Prill 2024 dhe kishte si qëllim përmirësimin e shërbimeve për moshën e tretë dhe të moshuarit e vetmuar. Ndërhyrjet nga ky projekt konsistonin në përmirësimin e kushteve të Qendrës ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i saj; Rritja e përfshirjes sociale të moshës së tretë nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të lidhura me këtë kategori dhe Ofrimi i shërbimit të asistencës shtëpiake, sociale, shëndetësore për të moshuarit e vetmuar. Impakti i projektit ishte tepër pozitiv për përfituesit por edhe për komunitetin pasi ka treguar qëndrueshmëri duke vijuar funksionimi i Qendrës Ditore për të moshuarit. Projekti përfundoi zbatimin në muajin Maj 2025.

✓ **PROJEKTE ME FINANCIM TË HUAJ NË ZBATIM:**

1. Projekti SEPAC (Mjedise të Qëndrueshme në Zonat e Mbrojtura për përdorim më të



mirë nga qytetarët) financuar nga IADSA ka si objektivi mbështetjen për rritjen e turizmit të qëndrueshëm të Bashkive të Përmetit dhe Këlcyrës, nëpërmjet promovimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve turistike. Ky projekt po realizohet në partneritet me organizatën CESVI dhe AKZM dhe konsiston në përmirësimin e infrastrukturës në fshatin Bënjë; aktivitete promovuese si Dita e Verës; përgatitja e një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit për Ujrat Termale dhe ndërtimi i një ballkoni panoramik. Projekti aktualisht është në fazën e procedurave për ndërhyrjet në infrastrukturë dhe pritet të përfundojë brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2026.

2. Projekti RIWET i financuar nga BE programi Interreg Europe (Qeverisja publiko-private e lumenjve dhe restaurimi dhe ruajtja e tyre si infrastrukturë blu&jeshile).

Bashkia Përmet është një ndër bashkitë e para në Shqipëri që përfiton nga ky program. Në këtë projekt Bashkia do të fokusohet te Lugina e Vjosës dhe deri tani janë realizuar takime periodike me grupet e interesit; shkëmbim eksperience nga praktikatat e mira të partnerëve; një video informuese e publikuar dhe në faqen zyrtare të bashkisë duke vijuar më tej me planin e aktiviteteve si takimet dhe shkëmbimet e eksperiencave me vendet partnere dhe identifikimi i praktikave të mira mbi menaxhimin e baseneve ujore në një prezantim për vizitën e partnerëve në Përmet në muajin Nëntor 2025.

3. Projekti ARCHETHICS Trashëgimia disonante evropiane si laborator i demokracisë. Projekti financohet nga programi URBACT IV i Bashkimit Evropian dhe bashkon nëntë qytete evropiane të madhësive të ndryshme, të cilat ndajnë praninë e një trashëgimie disonante me tipologji të ndryshme dhe ka si qëllim kryesor shkëmbimin e eksperiencave dhe hartimi i një plani veprimi të integruar për menaxhimin e trashëgimisë disonante në bashkëpunim me grupet e interesit. Aktualisht janë realizuar takime me grupet e interesit; u realizua një event në 18-19 Qershor ku partnerë nga vende të ndryshme të Evropës vizituan Përmetin dhe u njohën me trashëgiminë historike të Përmetit; stafi morri pjesë në takimet ndërkombëtare të zhvilluara nga partnerët; U krijua ULG (Grupi Lokal i Veprimit); u hartua një Plan veprimi për trashëgiminë disonante. Në vijim do të vijohet me realizimin e planit të aktiviteteve për periudhën e mbetur të zbatimit.

4. PROJEKTI EURBAN DECO “Eksplorimi i peisazheve urbane të BE-së për një dekonstrukcion të narrativave koloniale”. Ky Projekti shqyrton trashëgiminë koloniale brenda mjediseve urbane të Evropës duke eksploruar simbolet, tregimet dhe toponimet, ai synon të ekspozojë ndikimin e qëndrueshëm të ideologjive koloniale në qytetet e BE-së. Projekti financohet nga programi i Bashkimit Evropian CERV. Aktualisht janë realizuar hartat urbane duke përshkruar referencat kryesore të lidhura me trashëgiminë koloniale dhe eventit i zhvilluar në Përmet në 24-26 Qershor 2025 ku morrën pjesë partnerët ndërkombëtarë pjesë e projektit. Në vazhdim do të vijohet me realizimin e planit të aktiviteteve për periudhën e mbetur të zbatimit.

✓ **PROJEKTE NGA BUXHETI I BASHKISË**

Bashkia Përmet në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNDP për Programin RELOAD2 me Nr.2608 Prot datë 23.09.2021, ka hapur thirrje për financim për Organizatat e Shoqërisë Civile të cilat paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimore dhe prioritetet e Bashkisë. Për vitin 2025 Bashkia Përmet në thirrjen e shtatë të

publikuar në faqen zyrtare web, mbështeti me financim 2 projekte, pra 2 Organizata të Shoqërisë Civile që veprojnë po në Përmet.

Prioritetet e përcaktuara në konsultim edhe me OSHC-të ishin:

Disiplina sportive

1. Zhvillimi dhe mbështetja e aktiviteteve sportive futbollistike në Bashkinë Përmet
2. Zhvillimi dhe mbështetja e aktiviteteve sportive të basketbollit në Bashkinë Përmet
3. Zhvillimi dhe mbështetja e aktiviteteve sportive të ping-pongut në Bashkinë Përmet
4. Zhvillimi dhe mbështetja e aktiviteteve të alpinizmit në Bashkinë Përmet

Projektet fituese nisën zbatimin në muajin Shkurt 2025 dhe aktualisht është realizuar pjesa më e madhe e aktiviteteve të projektit kryesisht mbështetja e ekipeve për pjesëmarrje në garat kombëtare dhe ndërkombëtare. Dy shoqatat përfundojnë zbatimin brenda muajit dhjetor.

✓ **PROJEKTE ME FINANCIM NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

1. Projekti “Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë” Ky projekt i referohet

tipologjisë së shërbimit : Shërbim gjysmë ditor (mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në jetën social kulturore dhe 1 vakt ushqim) për kategoritë të moshuar të vetmuar, persona me PAK, pjesë e Komunitetit Egjyptian dhe individë në situatë të vështirë ekonomike. Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është Janar 2025- Dhjetor 2027. Aktualisht është ngritur dhe vënë në funksion qendra ditore në lagjen Mejden për të moshuarit duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë si dhe janë realizuar aktivitete sociale si Dita Botërore e të Moshuarve në datën 1 Tetor 2025 dhe shërbime në kujdes të shëndetit për frekuentuesit e qendrës.

Shërbimi i ofrimit të një vakti ushqimor për përfituesit nuk është realizuar ende pasi nuk pati asnjë ofertues në dy procedurat e hedhura nga bashkia. Bashkia Përmet ju drejtua Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara për të realizuar këtë procedurë dhe pasi të finalizohet dhe të kemi operatorin fitues të dërguar prej tyre do të vijojmë me lidhjen e kontratës dhe nisjen e zbatimit të ofrimit të këtij shërbimi.

Sfidat e hasura: Përgjithësisht Bashkia Përmet ka patur bashkëpunim të mirë me cdo partner të projekteve, institucionet e kontrollit të projekteve dhe ka zbatuar aktivitetet brenda afateve duke bërë që raportimet të pranohen nga Donatori dhe të njihen shpenzimet e realizuara. Sfida madhore që çenojnë ecurinë e zbatimit të projekteve nuk ka patur.

Të gjitha shpenzimet e realizuara për cdo aktivitet të projekteve janë paraqitur të detajuara në Raportin 8 Mujor të monitorimit të buxhetit miratuar me VKB Nr. 75 datë 23.09.2025.

Faleminderit!

**Drejtoria e Projekteve të Huaja/ Integritetit Evropian/
Performances dhe Dixhitalizimit të të dhënave**

Klaudja Ciko

